



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit
Uprava za Ekonomski Razvoj i Turizam
Department for Economic Development and Tourism

Tel / 038/200 46 010
kk.rks-gov.net/ferizaj
Adresa: Dëshmorët e Kombit

Procesverbal

Procesverbal nga konsultimi publik me qytetarë për Projekt- Krijimi i infrastrukturës turistike në fshatin Varosh të Komunës së Ferizajt për periudhën kohore 24 Maj 2025.

Ky takimi ka filluar në orën 10:00, ndërsa kanë marrë pjesë drejtues të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Denis Rashiti, Fatbardha Sallahu si dhe Shyhrete Topalli, udhëheqëse e Zyrës për Informim dhe Komunikim, mediat si dhe banorë të fshatit Varosh.

Ata për këtë projekt i ka njoftuar Denis Rashiti, zyrtarë i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit. Ai tha se në këtë zonë turistike është paraparë që të ketë pjesë të parkut, lodrave për fëmijë, shtigje për ecje dhe biçikleta, si dhe ka dhënë edhe detaje të tjera në lidhje me projektin.

Banorët e Varoshit, në këtë takim publik, thanë se e mirëpresin një ide të tillë, por kanë dhënë edhe disa propozime në mënyrë që të inkorporohen në projektin detaj që pritët të realizohet.

Ky projekt i cili pritët të fillojë se realizuari gjatë këtij viti, parasheh rregullimin e zonës turistike në fshatin Varosh, e cila gjendet tek fusha ekzistuese e futbollit të vogël.

Ky projekt përfshin rregullimin e rrugës hyrëse që lidh zonën me parkun për të siguruar qasjen më të lehtë për këmbësorët dhe automjete, pastaj pastrimin dhe renovimin e fushës ekzistuese të futbollit duke përmirësuar kushtet për aktivitete sportive dhe sociale, për të rinjtë dhe komunitetin lokal, do të bëhet rregullimi i shtigjeve të ecjes me zhavor që do të përdoren për shëtitje, vrapim dhe ecje në natyrë.

Habib Krosa përshëndeti të gjithë të pranishmit, ndërsa theksoi se ky projekt është i një rëndësie shumë të madhe për të gjithë banorët. Ai kërkoi që fusha sportive të bëhet më bari sintetik dhe të bëhet rregullimi i rrugës me zhavorr edhe për tek varrezat.

Razim Heta, ka përshëndetur të pranishmit, ndërsa ka pyetur se sa staza janë për ecje, si dhe rruga a do të jetë edhe për vetura, apo vetëm për këmbësorë?

Alban Krosa banor i fshatit Varosh ka kërkuar që ulëset të jenë të hapur dhe të mbyllura.

Ky takim takim ka përfunduar në orën 11:00

Procesverbal i datës: 16/04/2025

Procesmbajtëse



Fatbardha Shabani – Sallahu

